



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 154 Akti

Nr. 190 Vendimi
Tiranë, më 26.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. John Leonardo, në Tiranë, në datën 24 korrik 2019, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Ramiz Lala, gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, me funksionin gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.5.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Firdes Shuli dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioner, znj. Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 25.5.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala.
5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë

administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala.

12. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 12.7.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2019.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2018.

15. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në datën 12.7.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 15.7.2019, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 22.7.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 22.7.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ramiz Lala, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 24.7.2019, ora 10:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Ramiz Lala ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur; ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLD; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e

⁴ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar, “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala.

23.2 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

24. Apartament banimi⁵, me sip. banimi 86.6 m² (sip. shfrytëzimi 74.4 m² dhe sip. shërbimi 12.20 m²), ndodhur në, Rr. “***”, lagjja “***”, Tiranë, blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., në muajin prill të vitit 2010, me vlerë 51,960 euro, me pjesë takuese 100 %, në emër të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është fituar nëpërmjet kontratës së porosisë nr. ***, datë 19.4.2010, e cila është e pahipotekuar.

24.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit dhe të ardhurat nga pagat.

25. Hetimi i kryer nga Komisioni

25.1 ZVRPP-ja Tiranë⁶ nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.

25.2 Sipas kontratës së porosisë⁷ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka porositur nga shoqëria investitore “***” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 86.6 m², në objektin e ndërtuar në Rr. “***”, Tiranë. Çmimi për apartamentin është caktuar 600 euro/m². Vlera totale e apartamentit është 51,960 euro.

25.2.1 Në nenin 4 të kësaj kontrate me titull “mënyra e pagesës” parashikohet se: (i) kësti i parë prej 10,000 euro është paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) kësti i dytë prej 10,000 euro do të paguhet deri më 15 qershor të vitit 2010; (iii) kësti i tretë prej 10,000 euro do të paguhet deri në korrik të vitit 2010; (iv) kësti i katërt prej 10,000 euro do të paguhet deri në gusht të vitit 2010; (v) kësti i pestë prej 10,000 euro do të paguhet deri në tetor të vitit 2010 dhe; (vi) kësti i gjashtë dhe i fundit prej 1,960 euro do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit me marrjen e çelësave.

25.3 Shoqëria “***”⁸ sh.p.k., ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, i ka shlyer të gjitha detyrimet që ka pasur ndaj shoqërisë sipas kontratës së sipërmarrjes dhe se detyrimi që kanë pasur ndaj njëri-tjetrit në datën 27.1.2017 është zero, pasi janë shlyer tërësisht në bazë të kushteve dhe termave të përcaktuara në kontratë.

25.4 I pyetur nga Komisioni⁹ se si, dhe kur janë shlyer këstet në favor të sipërmarrësit, subjekti ka deklaruar se këstet janë shlyer si vijon: (i) kësti i parë në shumën 10,000 euro është paguar në datën 19.4.2010; (ii) kësti i dytë në shumën 10,000 euro është paguar në datën 11.6.2010; (iii) kësti i tretë në shumën 10,000 euro është paguar në datën 23.6.2010; (iv) kësti i katërt në

⁵ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së) – kontratë porosie nr. ***, datë 19.4.2010.

⁶ Shkresa nr. ***prot., datë 4.3.2019.

⁷ Kontrata nr. ***, datë 19.4.2010.

⁸ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***, shkresa nr. *** prot, datë 10.7.2017).

⁹ Pyetësori i dërguar me e-mail, datë 19.3.2019; përgjigjet e sjella me e-mail-in e datës 27.3.2019.

shumën 10,000 euro është paguar në datën 27.8.2010; (v) kësti i pestë në shumën 10,000 euro është paguar në datën 22.10.2010; (vi) në datën 16.12.2011 është paguar shuma prej 760 euro dhe; (vii) në datën 19.12.2014 është paguar shuma prej 1,200 euro. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues shkresën e shoqërisë “****” sh.p.k., të datës 26.3.2019.

25.4.1 Gjithashtu, subjekti ka paraqitur si provë procesverbalin e datës 16.12.2011, për marrjen në dorëzim të apartamentit të banimit, sipas së cilit, nga detyrimi total prej 51,960 euro, subjekti ka likuiduar shumën 50,760 euro dhe ka mbetur pa likuiduar shuma prej 1,200 euro, të cilën do ta likuidonte me dorëzimin e certifikatës së pronësisë, por jo më vonë se data 31.12.2014.

26. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj shoqërisë ndërtuese në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën periodike vjetore të viteve 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

26.1 Nisur nga fakti se detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese për vitet 2010 – 2014 ka qenë në vlera të vogla, Komisioni vlerëson se nuk ka dyshime se subjekti të ketë pasur si qëllim mosdeklarimin apo fshehjen e këtij detyrimi ndër vite, për sa kohë kishte deklaruar çmimin total të kësaj pasurie dhe se në deklarimin e bërë i është referuar kontratës së porosisë, e cila referon pagesën me këste për këtë pasuri, dhe konkretisht: shuma 1,960 euro do të paguhej në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë. Komisioni çmon se kemi të bëjmë me deklaram të pasaktë në deklaramet periodike vjetore për shkak të neglizhencës, fakt i pranuar edhe nga vetë subjekti, pasaktësi e cila, për shkak të mungesës së pasojës, nuk është marrë në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes.

27. Sikurse u evidentua edhe më lart, në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit dhe të ardhurat nga pagat.

27.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se në datën 2.4.2003 është regjistruar¹⁰ personi fizik “*Ramiz Lala*” për të ushtruar veprimtarinë private në profesionin e avokatit dhe është çregjistruar¹¹ në datën 28.12.2006.

28. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i avokatisë janë administruar të dhëna të ndryshme të deklaruara nga subjekti, si dhe të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, si më poshtë:

- i. në deklaratën “Vetting” shuma e të ardhurave nga ky aktivitet deklarohet në shumën 6,123,000 lekë;
- ii. në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat për periudhën 2000 – 2006, në vlerën prej afërsisht 50,000 euro;
- iii. DRT-ja Kukës, në përgjigje të kërkesës së bërë nga subjekti, me shkresën¹² e datës 20.1.2017, ka dërguar të dhënat lidhur me të ardhurat e realizuara nga personi fizik Ramiz Lala, për periudhën 2003 – 2006, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

¹⁰ Vendimi nr. ***, datë 2.4.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

¹¹ Vendimi nr. ***, datë 28.12.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

¹² Administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***, shkresa nr. ***prot., datë 20.1.2017).

Viti	Të ardhura të parashikuara (qarkullim) në lekë
2003	1,100,000
2004	1,200,000
2005	2,000,000
2006	2,000,000
Totali	6,300,000

iv. DRT-ja Kukës, me shkresat e datave 21.7.2017¹³, 8.2.2019¹⁴ dhe 29.3.2019¹⁵, ka dërguar të dhënat lidhur me të ardhurat e realizuara nga personi fizik “*Ramiz Lala*”, për periudhën 2003 – 2006, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Viti	Të ardhura të parashikuara (qarkullim) dhe të realizuara në lekë
2003	2,000,000
2004	2,200,000
2005	2,000,000
2006	2,000,000
Totali	8,200,000

v. Në përgjigje të pyetësorit¹⁶ të dërguar nga Komisioni, subjekti ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti i tij si avokat, duke pretenduar që të ardhurat *neto* për periudhën 2003 – 2006 janë në shumën 7,070,456 lekë, të ndara në vite si më poshtë:

Viti	Të ardhura <i>neto</i> në lekë
2003	1,742,880
2004	1,912,080
2005	1,721,600
2006	1,693,896
Totali	7,070,456

29. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për mospërputhjet lidhur me deklarinimin e të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i avokatisë, si dhe të paraqiste dokumentacionin justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat *neto* të përfituara nga ky aktivitet.

29.1 Subjekti ka shpjeguar¹⁷ se gabimi në pasqyrimin e të ardhurave *neto* të përfituara nga aktiviteti i avokatisë në deklaratën “*Vetting*” ka ardhur si pasojë e informacionit të pasaktë të vënë në dispozicion nga DRT-ja Kukës.

30. Komisioni vëren se në përgjigjen që DRT-ja Kukës¹⁸ i ka kthyer subjektit përpara dorëzimit të deklaratës “*Vetting*”, ka pasqyruar se qarkullimi i personit fizik “*Ramiz Lala*” për vitet 2003 – 2006 ka qenë 6,300,000 lekë. Bazuar në këtë të dhënë, në deklaratën “*Vetting*” subjekti ka deklaruar të ardhura *neto* të përfituara nga aktiviteti i avokatisë, shumën prej 6,123,000 lekësh.

¹³ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***, shkresa nr. ***prot., datë 23.2.2018).

¹⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 8.2.2019.

¹⁵ Shkresa nr. ***prot., datë 29.3.2019.

¹⁶ Pyetësori i dërguar me *e-mail*, datë 19.3.2019 / përgjigjet e sjella me *e-mail*-in e datës 27.3.2019.

¹⁷ Pyetësori i dërguar me *e-mail*, datë 19.3.2019 / përgjigjet e sjella me *e-mail*-in e datës 27.3.2019 dhe prapësimet e depozituara në Komision pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me *email*-et e datës 12.7.2019

¹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 20.1.2017.

31. Ndërkohë, në tri shkresa të ndryshme, njëra dërguar në ILDKPKI dhe dy të tjerat të dërguara në Komision, DRT-ja Kukës konfirmon se qarkullimi i këtij subjekti tregtar për vitet 2003 – 2006 ka qenë në vlerën 8,200,000 lekë. Bazuar në këtë informacion, subjekti ka pretenduar¹⁹ se të adhuroat *neto* nga aktiviteti i tij si avokat, pas zbritjes së shpenzimeve, kanë qenë rreth 7,000,000 lekë, ose rreth 85 % e qarkullimit (nuk ka përfshirë të ardhurat nga pagat, pasi i ka llogaritur si shpenzim). Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision²⁰ dokumentacionin e regjistrimit të subjektit tregtar, pasqyrat të përlllogaritjes së tatimit për vitet 2003 – 2006, mandatpagesa të tatim-fitimit të thjeshtuar, si dhe një vërtetim të vitit 2003 për shlyerjen e detyrimeve tatimore të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës.

32. Me prapësimet²¹ e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar si provë të re shkresën e DRT-së Kukës²², sipas së cilës rikonfirmohet qarkullimi i kryer prej 8,200,000 lekësh për vitet 2003 – 2006 nga tatimpaguesi Ramiz Lala. Gjithashtu, referuar kësaj shkrese, DRT-ja Kukës informon se bazuar në deklaratat e dorëzuara për vitet 2003 – 2006, ky subjekt tregtar ka kryer një volum të ardhurash *neto*, në total në vlerën prej **7,621,510 lekësh**, të detajuara si më poshtë:

Viti	2003	2004	2005	2006
Të ardhurat bruto/lekë	2,000,000	2,200,000	2,000,000	2,000,000
Tatim i thjeshtë mbi fitimin/lekë	80,000	88,000	60,000	80,000
Taksë vendore/lekë	9,000	15,000	15,000	15,000
Pagesë e sig. shoq/shënd në lekë	49,644	54,606	60,060	57,180
Të ardhura <i>neto</i>/lekë	1,861,356	2,042,394	1,864,940	1,847,820

33. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje (provave shkresore dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit) rezulton se tatimpaguesi “*Ramiz Lala*” me NIPT ***, për vitet 2003 – 2006, ka paguar detyrimet tatimore në DRT-në Kukës për qarkullimin e realizuar në total në vlerën prej 8,200,000 lekësh. Nisur nga kjo e dhënë, faktit se përlllogaritja e detyrimit tatimor është bazuar në vetëdeklarimin e subjektit, dhe se nuk kemi asnjë të dhënë tjetër që të vëreë në dyshim këtë qarkullim të vetëdeklaruar, Komisioni çmon se për këto vite të ushtrimit të aktivitetit, qarkullimi i realizuar nga tatimpaguesi “*Ramiz Lala*” është në vlerën 8,200,000 lekë.

34. Lidhur me të ardhurat *neto* të realizuara nga ky subjekt tregtar, Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë të ardhurat e pasqyruara në aktin e DRT-së Kukës²³ (të depozituar si provë e re nga subjekti), sipas të cilit të ardhurat *neto* të realizuara nga tatimpaguesi Ramiz Lala për vitet 2003 – 2006 janë në vlerën 7,621,510 lekë. Ky qëndrim bazohet në faktin se Komisioni nuk

¹⁹ Përgjigjet e sjella me *e-mail*-in e datës 27.3.2019.

²⁰ Dokumentacion, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

²¹ Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me *e-mail*-et e datës 12.7.2019.

²² Shkresa nr. *** prot., datë 16.7.2019.

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 16.7.2019.

evidentoi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm shpenzime të tjera të kryera²⁴ nga ky subjekt tregtar, përveçse shpenzimeve të njohura dhe të evidentuara në aktin e DRT-së Kukës.

Bazuar në sa më sipër, ka një pasaktësi në deklarinimin e të ardhurave nga aktiviteti i avokatisë, e cila ka ardhur pasojë e informacionit jo të saktë të vënë në dispozicion subjektit nga DRT-ja Kukës. Nisur nga ky fakt, si dhe nga fakti që subjekti ka deklaruar më pak të ardhura të realizuara sipas llogaritjeve të sipërpërmendura, Komisioni krijoi bindjen që pasaktësia në deklarinim është pa pasoja dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

35. Gjithashtu, në deklaratën “Vetting” të dorëzuar në ILDKPKI (deklarata e personit të lidhur), bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. V.L., ka deklaruar të ardhura nga vetëpunësimi në bujqësi për periudhën 1994 – 2006, shumë prej 1,650,000 lekësh, duke paraqitur si dokumentacion justifikues ligjor vërtetimin e ISSH-së²⁵, datë 9.1.2008, “*Për të vetëpunësuarit në bujqësi*”.

35.1 Sipas këtij vërtetimi, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. V.S.L., ka në pronësi/përdorim tokë dhe, që nga viti 1994 figuron e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe në regjistrin e të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. *** dhe me nr. libeze ***, sigurimi. Kontributet janë derdhur për vitet 1994 – 2006. Por, Komisioni vëren se nëpërmjet këtij vërtetimi nuk dokumentohen të ardhura e përfituara nga znj. V.L., nga ushtrimi i këtij aktiviteti.

35.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2²⁶, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij, si e vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1994 – 2006, që në vazhëri ka marrë tokë bujqësore në përdorim nga djali i dajës së saj, z. V.L. Subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues kontratën e huapërdorjes të datës 3.1.1994, si dhe dokumentacion lidhur me origjinën e pasurisë²⁷ të marrë me qira nga bashkëshortja e tij.

35.3 Në vijim, i pyetur nga Komisioni²⁸ se cili është dokumentacioni ligjor që vërteton përfitimin e këtyre të ardhurave, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: *Në vitet 1994 – 2006 bashkëshortja e tij ka qenë e vetëpunësuar në bujqësi dhe nga kjo veprimtari janë mbuluar nevojat familjare dhe pjesa tjetër është bërë shitje ambulante.*

36. Si përfundim, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, deklarimeve të dhëna dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1994 – 2006, ka ushtruar aktivitet si e vetëpunësuar në bujqësi, duke paguar edhe kontributet e sigurimeve shoqërore për këtë periudhë. Gjithsesi, Komisioni vlerësoi se nuk mund të marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruar në deklaratën “Vetting” si të përfituara nga ky aktivitet, pasi nuk janë provuar me dokumentacion justifikues ligjor.

37. Lidhur me këtë veprimtari nga e cila nuk janë evidentuar të ardhura, nisur nga fakti i provuar i vetëpunësimit në bujqësi të znj. V.L., – trupi gjykues vendosi²⁹ që në analizën financiare do të zbriten shpenzimet të cilat prezumohet se janë mbuluar nga produktet

²⁴ I pyetur nga Komisioni, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dërguar me e-mail-in e datës 27.3.2019, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur të punësuar dhe as zyrë me qira për ushtrimin e aktiviteti të avokatisë.

²⁵ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***, vërtetim i datës 9.1.2008).

²⁶ Pyetësori i dërguar me e-mail, datë 19.3.2019/ përgjigjet e sjella me e-mail-in e datës 27.3.2019.

²⁷ Vërtetimi nr. ***, datë 27.3.2019, i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Kukës.

²⁸ Pyetësori i dërguar me e-mail, datë 12.6.2019 / përgjigjet e sjella me e-mail-in e datës 18.6.2019.

²⁹ Vendimi i ndërmjetëm nr. 2, i trupit gjykues nr. 2, datë 26.6.2019.

bujqësore, të cilat vlerësohen se janë produkte që shërbejnë për ushqim dhe pije joalkoolike. Duke iu referuar rezultateve të anketës së buxhetit të familjeve në Shqipëri për vitet 2006 – 2007 (informacion i marrë nga faqja e *web-it* të INSTAT-it)³⁰, rezultoi se grupi i konsumit, ushqim dhe pijet joalkoolike, përbën 47.6 % të strukturës së konsumit.

38. Nisur nga fakti se rezulton e provuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1994 – 2006, ka ushtruar aktivitetet si e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe faktit që u vendos të bëhej kompensim i plotë i shpenzimeve për ushqim dhe pije joalkoolike (për periudhën 2000 – 2006) për arsye se nuk mund të pranohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm vetëdeklarimi i subjektit për të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet – Komisioni vlerëson se nuk mund të konsiderohet si deklarim i pasaktë apo deklarim i rremë deklarimi i bërë për të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit, si e vetëpunësuar në bujqësi.

39. Me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës prej 50,000 euro për likuidimin e një pjese të çmimit të pasurisë së llojit apartament, Komisioni kreu analizën e treguesve financiare lidhur me pasuritë, me të ardhurat dhe me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, duke marrë si pikë referimi të kësaj analize deklaratën fillestare të pasurisë, në të cilën janë pasqyruar pasuritë deri në datën në të cilën ai është emëruar në detyrë (datë 24.11.2010).

39.1 Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje (vërtetime pagash, dokumentacion bankar, vërtetime nga tatimet, dokumentacionin për porositjen e pasurisë së paluajtshme, etj.), deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara nga aktiviteti i avokatisë dhe për kompensimin e disa shpenzimeve për vitet 2000 - 2006 – analiza e treguesve financiarë për periudhën 1993 – 24.11.2010, paraqitet si më poshtë:

Analizë për periudhën 1993 – 24.11.2010

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit për periudhën 26.1.1993 – 31.1.1994 ³¹	61,732
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit për periudhën 1994 – 2000 ³²	1,539,065
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjekti për periudhën 2001 – 24.11.2010 ³³	3,100,725
Të ardhura e përfituara nga shërbimet (subjekti) ³⁴	155,100
Të ardhurat nga aktiviteti si avokat (2003 – 2006) ³⁵	7,621,510
Të ardhurat e bashkëshortes të vërtetuara për periudhën 2001 – 2010 ³⁶	810,922
Total të ardhura	13,289,054
Pagesë për U. Shkodër për bashkëshorten, datë 30.5.2008 (kaluar në “Raiffeisen Bank”)	50,000

³⁰ http://www.instat.gov.al/media/2067/buxheti_i_familjes.pdf

³¹ Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***).

³² Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***).

³³ Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***).

³⁴ Vërtetimet nr. *** prot., datë 20.1.2017 dhe nr. *** prot., datë 23.1.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***).

³⁵ Sipas shkresës së DRT-së Kukës me nr. ***prot., datë 16.7.2019.

³⁶ Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***).

Pagesë për sigurime vullnetare, bashkëshortja, datë 28.12.2006	27,307
Pagesë qiraje datë 1.11.2010 (2 muaj) sipas vetëdeklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit	15,000
Pagesë shpenzime jetese 2000 – nëntor 2010 (reduktuar shpenzimet për konsum, ³⁷ 2000 – 2006)	4,916,831
Total shpenzime	5,009,138
Ndryshim mj. monetare banke, gj. fillim – gj. fund periudhe	-4,952
Mjete monetare të disponueshme (1)	8,279,916
Pagesë për blerje autoveture “Benz 190” në vitin 2001	257,740
Pagese për blerje pjese takuese të tokës 755 m ² , në vitin 1994	173,650
Pagesë takuese për blerje apartamenti në Kukës (650,000 lekë*23,4%), sipas vetëdeklarimit	152,100
Pagesa për krijim pasurie, apartament në lagjen “****”, Tiranë, në vlerën 50,000 euro (kjo shumë paguar deri në datën 22.10.2010)	6,938,500
Detyrime deklaruar	0
Pasuri neto (2)	7,521,990
Balanca e fondeve (1-2)	757,926

40. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, lidhur me pasurinë e llojit apartament banimi objekt hetimi, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe analizës financiare të kryer për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se:

1. deklarimi i bërë nga subjekti në deklaratën “Vetting” përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje;
2. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja) kanë pasur aftësi paguese nga burime financiare të ligjshme, për kryerjen e pagesave përgjatë vitit 2010, për prenotimin e kësaj pasurie.

41. Tokë bujqësore me sip. 4,561 m²³⁸, e ndodhur në fshatin *** të rrethit Kukës, përfituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”. Subjekti ka deklaruar se zotëron 20 % pjesë takuese të kësaj pasurie.

42. Hetimi i kryer nga Komisioni

42.1 ZVRPP-ja Kukës³⁹ nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit. Me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, subjekti ka paraqitur si dokumentacion provues vërtetimin nr. ***, datë 21.1.2016, të Këshillit të Qarkut Kukës, sipas të cilit babai i tij, z. Sh. R.L., ka përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar, dhe konkretisht, pasurinë e llojit tokë arë, me sip. totale 4561 m². Duket se subjekti zotëron 20 % të kësaj pasurie (të drejta reale mbi të) për shkak të ligjit, si anëtar i familjes bujqësore në momentin kur kjo pasuri është përfituar në emër të babait të tij (si kryefamiljar).

³⁷ Shpenzimet për ushqim dhe pije joalkoolike.

³⁸ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së): - vërtetim nr. ***, datë 21.1.2016, të Këshillit të Qarkut Kukës.

³⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 31.1.2019.

42.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁴⁰, subjekti ka shpjeguar se pjesa 20 % e sipërfaqes së mësipërme është përcaktuar mbi bazën e përbërjes familjare, datë 1.8.1991, dhe faktin se nëna e tij kishte ndërruar jetë përpara vitit të deklarimit të pasurisë, para fillimit të detyrës. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo tokë është e braktisur, nuk përdoret nga asnjë anëtar i familjes dhe statusi i saj është djerrë. Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti ka depozituar si prova të reja: (i) certifikatën e përbërjes familjare të datës 1.8.1991; si dhe (ii) dokumentin, Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) me nr. regjistri ***.

43. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se deklarimi i tij përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.

44. Tokë arë + truall⁴¹, me sip. 755 m², ndodhur në Njësinë Administrative *** (***), regjistruar në ZVRPP, në z.k. ***, e ndarë në: (i) pasuria nr. *** me sip. totale 615 m²⁴²; (ii) pasuria nr. *** me sip. 68.7 m²; dhe (iii) pasuria nr. *** me sip. 71.3 m².

44.1 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: (i) kontratën e pjesëtimit të pasurisë e llojit tokë arë, me sip. totale 3,000 m², me nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, ndërmjet bashkëpronarëve Z.I.L., Z.I.L., F.I.L., V.D.L., dhe R.Sh.L.; dhe (ii) kontratën e shitblerjes së tokës bujqësore me nr. ***, datë 2.2.2015.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë pa dokument pronësie nga babai i tij, z. Sh.L., në vitin 1994.

45. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: (i) referuar deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës⁴³, subjekti ka deklaruar tokë truall me sip. 600 m², në Komunën *** (***), e paregjistruar në zyrën hipotekore, në proces regjistrimi në emër të babait të tij. Gjithashtu, lidhur me këtë pasuri subjekti ka deklaruar se është blerë në vitin 1993, në shumën 60,000 lekë dhe se zotëron 50 % pjesë të saj; (ii) referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se në emrin e tij është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, lloji i pasurisë arë + truall, me sip. 615 m², nga kjo, 90.5 m² truall dhe 90.5 m² sip. ndërtimore, me nr. pasurie ***, z.k. ***, ndodhur në ish-Komunën *** (***), sipërfaqe e tokës e deklaruar më parë në bashkëpronësi me babain e tij, z. Sh.L., – ka deklaruar se zotëron 100 % të kësaj pasurie; dhe (iii) referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar pasurinë nr. ***, me sip. 68.7 m² dhe pasurinë nr. ***, me sip. 71.3 m², ndarë nga lloji i pasurisë arë me sip. 140 m². Duket se këto dy pasuri janë regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në vitin 2016.

46. Hetimi i kryer nga Komisioni

46.1 ZVRPP-ja Tiranë⁴⁴ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi dhe figuron të ketë pasur në pronësi pasuritë: (i) pasuria nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit arë + truall, me sip. 615 m² dhe 90.5 m² ndërtim; (ii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, e llojit arë, me sip. 68.70 m²; dhe (iii) pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, e llojit arë, me sip. 71.30 m².

⁴⁰ Pyetësori i dërguar me *e-mail* datë 12.6.2019 / përgjigjet e sjella me *e-mail*-in e datës 18.6.2019.

⁴¹ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks ***në dosjen e ILDKPKI-së): 3 certifikata për vërtetim pronësie; kontratë shitblerjeje toke bujqësore nr. ***, datë 2.2.2015; kontratë pjesëtimi vullnetar e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 5.3.2015.

⁴² Nga e cila 90.5 m² truall dhe ndërtesë.

⁴³ Dorëzuar në datën 22.12.2010 në ILDKPKI.

⁴⁴ Shkresa nr. ***prot., datë 4.3.2019.

46.2 Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti (që gjendet në dosjen e ILDKPKI-së) rezulton se në datën 2.2.2015, nëpërmjet kontratës së shitblerjes së tokës bujqësore⁴⁵, shtetasit Z.L., Z.L., F.L., V.L., dhe Ramiz Lala kanë blerë nga shtetasit L., dhe F.C., pasurinë e llojit arë me sip. totale 3,000 m², të ndodhur në ***, Tiranë.

46.2.1 Në këtë kontratë përcaktohet: “...shitësit bashkëpronarë deklarojnë se pronën e lartpërmendur me sipërfaqe 3000 m², e cila sipas vërtetimit të Komunës *** ndodhet në ***, Tiranë, ia shesin blerësve bashkëpronar Ramiz Lala, etj., në shumën 690,000 lekë, të cilët pranojnë ta blejnë me çmimin e ofruar. Kjo shumë është likuiduar pa asnjë pretendim nga palët që në vitin 1994, por për arsye se dokumentacioni doli më vonë, atëherë kontrata lidhet në datën e sotme.”

46.2.2 Në datën 5.3.2015, nëpërmjet kontratës së pjesëtimit vullnetar të pasurive të paluajtshme⁴⁶, me vullnet të lirë të bashkëpronarëve është bërë pjesëtimi i kësaj pasurie, nga ku:

- i. sipërfaqja S5 = 615 m² do të jetë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala;
- ii. sipërfaqja S6 = 140 m² do të jetë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala.

46.3 Në dosjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë lidhur me këtë pasuri, vërehet se subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë që pasurinë e llojit arë me sip. 140 m² ta ndajë në dy pjesë, sipas plan-rilevimit që i ka bashkëlidhur kërkesës, dhe konkretisht, në pasurinë me sip. 68.7 m² dhe pasurinë me sip. 71.3 m².

46.3.1 Mbi bazën e këtij dokumentacioni, ZVRPP-ja Tiranë ka regjistruar këto pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit. Rezulton se subjekti është pajisur me certifikata pronësie për këto pasuri.

47. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton se, në datën 21.3.2017 (pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”), nëpërmjet kontratës së shitjes⁴⁷, subjekti i ka shitur shtetasit L.B., pasurinë e llojit tokë arë me sip. 71.30 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, të ndodhur në ***, Tiranë, për vlerën 32,000 lekë.

48. Me pyetësin e datës 12.6.2019 Komisioni i kërkoi subjektit të dhëna shtesë lidhur me këtë pasuri, dhe konkretisht: (i) origjinën fillestare të kësaj pasurie, dokumentacion justifikues për blerjen e kësaj pasurie nga babai i tij në vitin 1993, apo 1994; (ii) në ç’mënyrë ia ka kaluar babai të drejtat reale mbi këtë pasuri; (iii) vlerën e paguar nga babai i tij dhe periudhën e kryerjes së pagesës; si dhe (iv) dokumentacion justifikues ligjor lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

i. Lidhur me origjinën e kësaj pasurie

Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri e llojit tokë arë është përfituar për shkak të ligjit (ligji nr. 7501) nga familja me kryefamiljar z. L.C. Në vitin 1993 babai i tij, z. Sh.L., dhe kushëriri i tij z. F.L., kanë bërë marrëveshje verbale me pronarin e tokës bujqësore për blerjen e sipërfaqes prej 3,000 m², me çmim 100 lekë/m². Pas marrëveshjes është bërë një pjesë pagese si “kapar” dhe pjesa tjetër është likuiduar në maj të vitit 1994, në vlerë totale 300,000 lekë. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se, meqenëse prona nuk ishte e regjistruar, nuk mund të lidhej kontratë shitblerjeje për kalimin e saj. Me bërjen e pagesës, sipërfaqja e tokës është ndarë në pesë pjesë

⁴⁵ Kontrata nr. ***, datë 2.2.2015.

⁴⁶ Kontrata nr. ***, datë 5.3.2015.

⁴⁷ Kontrata nr. ***, datë 21.3.2017.

dhe grupuar në dy - tri pjesë. Nga hedhja e shortit janë pozicionuar dhe sot banesat. Vetëm në vitin 2014 është mësuar se shitësit kishin kryer procedurat për regjistrimin e sipërfaqes së tokës bujqësore dhe me vënien në dijeni të këtij fakti është lidhur kontrata e shitjes, e cila është depozituar së bashku me deklaratën “Vetting”.

ii. *Lidhur me mënyrën e kalimit të të drejtave reale mbi këtë pasuri*

Subjekti ka deklaruar se kjo sipërfaqe toke i ka kallur atij si rezultat i dhënies së pëlqimit të babait të tij, z. Sh.L., për kalimin e pronës së mësipërme në pronësinë e tij pa pasur asnjë pretendim pronësie apo pretendim financiar, konkretizuar me kontratën e shitjes së vitit 2015.

iii. *Lidhur me vlerën e paguar për blerjen e kësaj pasurie dhe dokumentacionin ligjor lidhur me burimin e krijimit të saj*

Subjekti ka deklaruar se pagesa e plotë e sendit/pasurisë tokë arë me sip. 3,000 m² është kryer nga z. F.L., në shumën 240,000 lekë dhe nga babai i tij, z. Sh.L., në shumën 60,000 lekë. Pagesa tjetër prej 60,000 lekësh është kryer në vitin 1995 nga babai i subjektit, z. Sh.L. Por, subjekti sqaron se babai i tij nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor për blerjen e kësaj prone, duke qenë se ka pasur vetëm një marrëveshje verbale midis palëve. Lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga babai i tij, subjekti ka deklaruar se janë të ardhurat familjare ndër vite, si: (i) kursimet e kryera si familje deri në atë moment; si dhe (ii) të ardhurat nga shpërblimi i marrë për vrasjen e gjyshit të tij nga regjimi komunist. Subjekti ka depozituar si provë: (1) librezë nga dega e Bankës së Kursimeve, Agjencia Bankare Kukës; (2) shkresë nga “Raiffeisen Bank” drejtuar z. Sh.L.; dhe (3) deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.6.2019.

49. Referuar deklaratës noteriale⁴⁸ të datës 18.6.2019, të nënshkruar nga shtetasit L.C., F.L., dhe Sh.L., rezulton se z. L.C., deklaroi se ka përfutur tokë arë nga ligji nr. 7501 “Për tokën” dhe ka biseduar me z. F.L., për të realizuar shitjen e sip. prej 3,000 m², i cili ka deklaruar se tokën do ta blejë bashkërisht me vëllezërit dhe kushëririn e tij, z. Sh.L. Në vijim, në këtë deklaratë pasqyrohet mënyra e kryerjes së pagesës, periudha e kryerjes së saj, ndarja e tokës, si dhe formalizimi i kontratës së shitjes në vitin 2015.

50. Gjithashtu, për sa i përket çmimit të vendosur në kontratën e shitjes të vitit 2015, subjekti ka deklaruar se noteri ka vendosur çmimin për m² referencë që dispononte ZVRPP-ja Tiranë në momentin e kryerjes së veprimit juridik, kalimit të pronësisë.

51. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjekti vuri në dispozicion dokumentacion⁴⁹ lidhur me origjinën e kësaj pasurie, nga ku konfirmohet se pasuria e llojit arë me sip. 3,000 m² (pjesë e së cilës është edhe pasuria në emër të subjektit, objekt hetimi), e ndodhur fshatin *** është regjistruar në z.k. ***, vol. ***, f. ***, fillimisht në pronësi të shtetasit L.C., bazuar në procedurën nr. *** prot., datë 7.11.2014, e nisur nga komuna ***⁵⁰ dhe Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

52. Referuar të dhënave të mësipërme, duket se kjo pasuri tokë arë dhe pasuria tokë truall mbi të cilën është ngritur objekti godinë 2-katëshe karabina (e cila do të trajtohet si pasuri më vete) është poseduar, përdorur, shfrytëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij më parë se të nënshkruhej kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie. Ky fakt konfirmohet nga prova shkresore

⁴⁸ Deklarata noteriale me nr. ***, datë 18.6.2019.

⁴⁹ Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Kamëz - Vorë e datës 22.7.2019 dhe dokumentacioni bashkëlidhur saj.

⁵⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 7.11.2014.

dhe deklaratimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, babai i subjektit të rivlerësimit, si dhe persona të tjerë të përfshirë në këtë transaksion.

52.1 Është fakt se babai i subjektit të rivlerësimit rezulton aplikues⁵¹ që në vitin 2006 për legalizimin e objektit me sip. 30 m², me sip. të zënë 500 m², e ndodhur në ***, Tiranë, pasuri që përkojnë pikërisht me tokën pasuri objekt hetimi. Po ashtu, vetë subjekti i rivlerësimit, në vitin 2013 ka aplikuar⁵² për legalizimin e një shtëpie banimi në ndërtim e sipër, kolona + soletë 2 kate, me sip. ndërtimi 92 m² dhe sip. e përgjithshme 209 m², të ndërtuar mbi këtë pasuri, të formalizuar me kontratë shitblerjeje nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2015.

52.2 Sikurse është evidentuar edhe më sipër, në deklaratën e para fillimit të detyrës (dorëzuar në datën 22.12.2010 në ILDKPKI), subjekti ka deklaruar 600 m² tokë truall⁵³, në komunën *** (***) , e paregjistruar në zyrën hipotekore, në proces regjistrimi në emër të babait të tij, duke shpjeguar se kjo pasuri është blerë në vitin 1993, në shumën 60,000 lekë dhe se zotëron 50 % pjesë të saj. Në kuptim të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni.

52.3 Vlen të theksohet se vetë kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie referon rregullimin e një marrëdhënieje juridike të konsumuar *de facto* në të shkuarën dhe se është në harmoni me deklaratimet e dhëna në kuadër të hetimit administrativ nga subjektet, pjesë e kësaj marrëdhënieje.

53. Për sa më sipër, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie duken bindëse, kjo në këndvështrimin e informalitetit të ekonomisë që e ka karakterizuar vendin gjatë viteve të caktuara dhe traditës shqiptare që lidhet me karakterin patriarkal të familjes.

54. Si përfundim, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti për mënyrën e përfitimit të pasurisë së llojit tokë arë dhe truall, Komisioni vlerëson se:

1. subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këto pasuri dhe se deklarimi i tij përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, për gjendjen e këtyre pasurive në momentin e deklaratimit;
2. shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie duken bindëse dhe nuk ka dyshime për ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre.

55. Shtëpi banimi karabina⁵⁴, me sip. baze ndërtimi 90.5 m², dy kate, sip. totale ndërtimi 181 m², regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. pasurie ***, z.k. ***, pasuri në bashkëpronësi të pjesëtarëve të familjes. Vlera e deklaruar është 998,780 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e banesës në Kukës.

56. Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2013 subjekti ka deklaruar se ka paraqitur në degën e ALUIZNI-t *** kërkesën për legalizimin e një shtëpie banimi në ndërtim e sipër, kolona + soletë 2 kate, me sip. ndërtimi 92 m² dhe sip. e

⁵¹ Formulari A, nr. *** prot., datë 14.11.2006.

⁵² Formulari i vetëdeklarimit nr. ***, datë 8.7.2013.

⁵³ Ka shpjeguar se në deklaratën para fillimit të detyrës e ka deklaruar tokë truall, për faktin se në vetëdeklarimin e bërë në zyrat e ALUIZNI-t (viti 2006), babai i tij ka kërkuar për legalizimin tokë truall.

⁵⁴ Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks ***në dosjen e ILDKPKI-së): (1) certifikatë për vërtetim pronësie; (2) leje legalizimi nr. ***, datë 25.5.2015; (3) situacion i pjesshëm i punimeve të kryera për objektin deri në datën 10.6.2013; (4) kontratë shitje apartamenti nr. ***, datë 28.12.2006; dhe (5) kontratë shitje pasurie me nr. ***.

përgjithshme 209 m². Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se vlera e investuar për ndërtim është 998,780 lekë dhe se *kjo pasuri është në bashkëpronësi familjare*.

56.1 Subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI situacionin e pjesshëm të punimeve të datës 10.6.2013 për këtë objekt, përpiluar nga tekniku M.L., sipas të cilit, vlera totale e tij është llogaritur 998,780 lekë.

57. Hetimi i kryer nga Komisioni

57.1 ALUIZNI, Drejtoria Kamëz - Vorë⁵⁵ konfirmon se subjekti i rivlerësimit, me anë të formularit të vetëdeklarimit nr. ***, datë 8.7.2013, ka vetëdeklaruar për legalizim objekt informal me adresë: ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Kamëz. Në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, subjekti është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 25.5.2015, për objektin godinë banimi, 2 kate, të ndodhur në z.k. ***, Komuna ***, Qarku Tiranë. Objekti është legalizuar si objekt informal i ndërtuar në tokë, në pronësi të poseduesit të objektit informal, konkretisht në pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***.

57.1.1 Në datën 18.6.2015, Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë⁵⁶ i ka përcjellë ZVRPP-së Tiranë dokumentacionin tekniko-ligjor për regjistrimin e kësaj pasurie. Referuar dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë⁵⁷, lidhur me këtë pasuri (kartelës së pasurisë), rezulton se kjo godinë është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 16.11.2015, bazuar në lejen e legalizimit nr. ***, datë 25.5.2015 dhe se, në po të njëjtën datë është lëshuar certifikata e pronësisë mbi këtë pasuri.

57.2 I pyetur nga Komisioni⁵⁸, subjekti ka konfirmuar se kjo godinë aktualisht ndodhet në gjendje karabina. Ai ka depozituar si provë foto të objektit.

57.3 Nga verifikimi i dosjes së legalizimit konstatohet se, në datën 24.4.2015, babai i subjektit, z. Sh.L., në deklaratën noteriale⁵⁹ ka deklaruar: "*...banesën të cilën e ka në proces legalizimi pranë Komunës *** Tiranë, sipas vetëdeklarimit për legalizim nr. *** prot., është dakord që ta vazhdojë dhe ta kalojë në emrin e subjektit, pa asnjë pretendim pronësie ose financiar.*"

57.3.1 Pjesë e dosjes së legalizimit është edhe vërtetimi i datës 17.4.2015 i komunës Paskuqan, sipas të cilit babai subjektit, z. Sh.L., banues në fshatin *** ka dorëzuar dokumentet për legalizim të banesës, ku figuron me nr. *** të fshatit *** dhe se, në bazë të konstatimit, figuron me 500 m² sip. truall dhe me sipërfaqe të gjurmës së ndërtimit 30 m² ndërtim. Ky vërtetim është lëshuar me kërkesën e të interesuarit dhe mban shënimin me shkrim të lirë dore "*për kontratë energjie*".

57.4 ASHK-ja⁶⁰ informon se nga verifikimi në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve, shtetasi Sh.L., (babai subjektit) rezulton aplikues në procesin e legalizimit, me formular A, nr. *** prot., datë 14.11.2006, ***, Tiranë.

57.5 ASHK-ja⁶¹, Drejtoria Vendore Kamëz - Vorë, informon se shtetasi Sh.R.L., (babai subjektit) ka vetëdeklaruar për legalizim objekti informal formularin e vetëdeklarimit nr. ***,

⁵⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2019.

⁵⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 18.6.2015.

⁵⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019.

⁵⁸ Pyetësori i dërguar me e-mail datë 12.6.2019 / përgjigjet e sjella me e-mail-in e datës 18.6.2019.

⁵⁹ Deklarata nr. ***.

⁶⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 20.5.2019.

⁶¹ Shkresa nr. *** prot., datë 20.5.2019.

datë 14.11.2006, me adresë: ***, Njësia Administrative ***, Bashkia Kamëz dhe se, praktika e legalizimit nuk është trajtuar në kushtet kur objekti nuk i është nënshtruar verifikimit të objektit informal në terren. Referuar formularit të vetëdeklarimit ky shtetas ka aplikuar për legalizimin e objektit me sip. 30 m², me sip. të zënë 500 m².

57.6 Lidhur me kalimin e së drejtës për të legalizuar këtë objekt informal nga z. Sh.L., te subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se e drejta e posedimit të sendit është një e drejtë e cila është lirisht e transferueshme në qarkullimin civil, sipas dispozitave të Kodit Civil. Në këtë kuptim, vetëdeklaruesi ka tagrin që në çdo moment të disponojë mbi të drejtën subjektive të transferimit të së drejtës së legalizimit të objektit informal të vetëdeklaruar nga ana e tij.

57.6.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁶², subjekti ka deklaruar se: (i) babai i tij nuk ka kryer aplikim për legalizim objekti informal me sip. bazë ndërtimi 90.5 m², 2 kate dhe sip. ndërtimi 181 m²; (ii) nuk ka ndryshim në vetëdeklarimin e babait të tij për legalizimin e objektit informal të deklaruar me formularin nr. ***, datë 14.11.2006; (3) babai i tij ka bërë një deklaratë noteriale për kalimin e të drejtës së legalizimit për këtë objekt, por se nuk është bërë asnjë veprim pranë ALUIZNI-t për kalimin e sendit dhe regjistrimin e tij në emrin e subjektit; dhe (4) ky objekt ndodhet në sipërfaqen e tokës në pronësinë e tij dhe është me mur me blloqe betoni, pa tavan, i mbuluar me llamarinë.

57.7 ASHK-ja⁶³, Drejtoria Vendore Kamëz - Vorë, informon se nga verifikimi në terren është konstatuar se babai i subjekti Sh.L., ka vetëdeklaruar për legalizim objektin informal "*kasolle – pa funksion*", objekt i paqëndrueshëm (objekti nuk është i ndërtuar me materiale të qëndrueshme, i ngritur në strukturë dhe nuk plotëson kushtet për regjistrim sipas legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme). Gjithashtu, konfirmohet se ky objekt nuk është i njëjti me objektin godinë banimi, 2 kate, për të cilin është lëshuar leja e legalizimit në emrin e subjektit të rivlerësimit. Lidhur me deklaratën noteriale të depozituar nga z. Sh.L., (babai subjektit) sipas së cilës ai ka shprehur vullnetin që procedurat e legalizimit të këtij objekti informal të kalojnë në emrin e subjektit, ASHK-ja informon se veprimi juridik i kalimit të së drejtës për të legalizuar objektin informal i nënshtrohet verifikimit të kushteve formale në momentin e trajtimit të praktikës së legalizimit kryesisht lidhur me procedurat e nënshkrimit të aktit nga bashkëshortët vetëdeklarues, si dhe pëlqimin e palës mbi të cilën kalon e drejta e legalizimit.

57.7.1 Si përfundim, lidhur me këtë objekt, konstatohet se në fazën në të cilën ndodhet procedura administrative, z. Sh.L., paraqitet në cilësinë e vetëdeklaruesit të këtij objekti informal me sip. 30 m².

57.8 Sikurse është evidentuar më sipër, në deklaratën "Vetting" subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë, godinë 2-katëshe karabina, të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në qytetin e Kukësit, e cila ishte në bashkëpronësi me familjarët e tij.

57.9 Subjekti ka deklaruar se ndërtimi i kësaj godine është kryer nga babai i tij dhe se me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në vitin 2011, është likuiduar babai për shpenzimet në kryerjen e ndërtimit⁶⁴.

⁶² Pyetësori i dërguar me e-mail datë 12.6.2019 / përgjigjet e sjella me e-mail-in e datës 18.6.2019.

⁶³ Shkresa nr. ***prot., datë 2.7.2019.

⁶⁴ Referohuni përgjigjeve të pyetësorëve dhe prapësimeve të dërguara nga subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

57.10 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar pakësim pasurie të paluajtshme, apartamentin e banimit me sip. 85 m² në Kukës (deklaruar si pasuri në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës), shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 1.7.2011, në vlerën 4,400,000 lekë, ku ka përcaktuar pjesën takuese të tij 23.4 %.

57.11 Në deklaratën noteriale⁶⁵ të datës 23.3.2019, babai subjektit, z. Sh.L., deklaroi: *...ndërtimi i karabinasë, objekt shqyrtimi ka filluar përgjatë vitit 2013 dhe është përfunduar prej tij deri në fazën aktuale. Me përfundimin e ndërtimit të objektit karabina u ra dakord midis tij dhe djalit të tij, që ky objekt të deklarohet në pronësi të djalit të tij z. Ramiz Lala, pasi nga të ardhurat që ishin përfutuar nga shitja e pasurisë në qytetin e Kukësit, në të cilën djali i tij, z. Ramiz Lala, ishte bashkëpronar, nuk kishte marrë pjesën e tij takuese në vlerë monetare, pasi të gjitha të ardhurat nga shitja i kaluan kryefamiljarit, z. Sh.L.*

57.12 ZVRPP-ja Kukës⁶⁶ konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur pasuri të regjistruar dhe se kjo pasuri është shitur nga ana e tij. Rezulton se në datën 1.7.2011, subjekti i rivlerësimit dhe pesë bashkëpronarët e tjerë kanë shitur⁶⁷ pasurinë e llojit apartament për vlerën 4,400,000 lekë.

57.12.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kukës konstatohet se, në datën 28.12.2006 subjekti i rivlerësimit ka blerë⁶⁸ nga Enti Kombëtar i Banesave⁶⁹ këtë apartament në vlerën 676,000 lekë. Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie (të firmosur në cilësinë e blerësit vetëm nga subjekti i rivlerësimit), si bashkëpronarë mbi këtë pasuri njihen edhe katër pjesëtarët e tjerë të familjes (sipas certifikatës së gjendjes familjare). Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, fillimisht ka zotëruar 20 % të kësaj pasurie.

57.13 Bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, në datën 2.4.2010 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka vendosur⁷⁰ lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësen H. D.L., (e ëma e subjektit të rivlerësimit), duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjor të radhës së parë bashkëshortin dhe pesë fëmijët e saj, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta, secili nga 1/6 pjesë të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënëses.

57.14 Meqenëse znj. H.L., kishte qenë bashkëpronare e pasurisë së llojit apartament të blerë nga Enti i Banesave në vitin 2006 (të përshkruar si më lart) dhe zotëronte 20 % pjesë takuese të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, ka përfituar 1/6 e 20 % pjesë takuese të mamasë së tij, pra edhe 3,33 % të kësaj pasurie. Në total, para shitjes së kësaj pasurie, subjekti ka zotëruar 23,3 % të saj.

57.15 Gjithashtu, referuar dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Kukës lidhur me këtë pasuri rezulton se ky apartament është rivlerësuar paraprakisht në vitin 2010 në vlerën 2,892,550 lekë dhe se, në momentin kur është shitur nga subjekti, është llogaritur dhe paguar tatimi mbi diferencën në çmim, konkretisht, është paguar tatimi në vlerën 150,745 lekë.

⁶⁵ Deklarata nr. ***, datë 23.3.2019.

⁶⁶ Shkresa nr. ***prot., datë 31.1.2019

⁶⁷ Kontrata nr. *** kol., datë 1.7.2011.

⁶⁸ Kontratë shitje apartamenti me pagesë të menjëhershme nr. ***, datë 28.12.2006.

⁶⁹ Drejtoria Rajonale Kukës.

⁷⁰ Vendimi nr. ***, datë 2.4.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

57.16 Nga analizimi i të dhënave të mësipërme konstatohet se pjesa në vlerë monetare që i takon subjektit pas shitjes së kësaj pasurie në vitin 2011 është 1,025,000 lekë (23,3% * 4,400,000).

57.17 Komisioni vëren se, nga verifikimi i dokumentacionit dhe i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara ndër vite në ILDKPKI, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar ndonjëherë pjesën e tij takuese nga shitja e apartamentit në Kukës dhe në asnjë rast subjekti nuk ka përdorur si burim krijimi të ndonjë pasurie vlerën monetare takuese nga shitja e kësaj pasurie në Kukës në vitin 2011. Si rrjedhim, Komisioni krijoi bindjen se shpjegimet dhe deklaratimet e subjektit lidhur me shumën që ka shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie nga i ati, janë të bazuara.

57.18 Siç u evidentua edhe më sipër, subjekti ka deklaruar se vlera e punimeve për këtë objekt për fazën në të cilën ndodhet (karabina) është 998,780 lekë, duke e mbështetur deklaratimin e tij në një situacion të pjesshëm të punimeve, të përpiluar nga tekniku M.L., në datën 10.6.2013, për z. Sh.L.

57.19 Referuar marrëveshjes së datës 17.5.2006⁷¹, “Për përcaktimin e treguesve minimale për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”, në tabelën nr. 3 të saj, ndër të tjera, përcaktohet volumi që zënë zërat e punimeve, si vijon: (i) gërmimet me makineri zënë 0.3 % të volumit të punimeve; (ii) struktura beton-arme zënë 36.4 % të volumit të punimeve; dhe (iii) vendosje hekur betoni zënë 7.7 % të volumit të punimeve.

57.20 Pra, në total, këto punime zënë 44.4 % të volumit të punimeve dhe të vlerës së ndërtimit të objektit, të cilat Komisioni vlerëson se janë punimet e kryera për godinën 2-katëshe në gjendje karabina, të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

57.21 Konkretisht, për sipërfaqen ndërtuese 181 m², referuar vlerës për koston mesatare për ndërtim në vitin 2013 (udhëzim nr. 1, datë 8.5.2013) në qytetin e Tiranës, dhe volumit të punimeve të kryera sa më sipër, vlera e karabinasë së ndërtuar vlerësohet se është afërsisht 2,414,938 lekë (181 m² * 30,050 lekë/sip. ndërtimi * 44.4 %).

57.22 Për sa më sipër, nëse do t'i referohemi kësaj vlere të koston së banesës (në fazën karabina, vlerësuar në shumën 2,414,938 lekë), dukej se subjekti nuk kishte deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie.

57.23 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu la barra e barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij lidhur me dyshimin e ngritur nga Komisioni për mosdeklarimin e vlerës reale të objektit godinë 2-katëshe, karabina.

57.24 Me prapësimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se vlerësimi i koston reale të investimit për ndërtimet informale nuk mund të bëhet duke përdorur referencat e koston mesatare të ndërtimit sipas udhëzimeve ndër vite të Entit Kombëtar të Banesave, si dhe ka parashtruar edhe argumentet e tij, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- këto udhëzime të Entit Kombëtar të Banesave përcaktojnë çmimet e koston për metër katror për ndërtime të rregullta të kryera me leje nga subjekte ndërtimi, për të cilat argumenton se kanë kosto shtesë në ndërtimin e objekteve;

⁷¹ Lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë.

- ndërtimi i këtij objekti është bërë me krahë duke mos u përdorur makineri, punime të kryera nga babai i tij dhe të afërm të tij;
- ndërtimi i këtij objekti është bërë nga babai i tij për të cilin shpjegon se ka pasur burime financiare të ligjshme, pasi ka disponuar tërësisht shumën e përfituar nga shitja e apartamentit në Kukës, përveç të ardhurave që ka përfituar ndër vite nga pensioni i pleqërisë.

57.25 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë akt ekspertimin e datës 15.7.2019, me objekt: *Vlerësimin e gjendjes ekzistuese të objektit godinë 2-kate karabina, të ndodhur në rrugën “***”,***, Tiranë.* Ky akt ekspertimi është përpiluar nga ekspertë të fushës, inxhinieret e licencuar, z. A.M.,⁷², z. G.S.,⁷³ dhe z. A.P.⁷⁴. Referuar këtij akt ekspertimi rezulton se ky grup inxhinierësh konstruktor kanë dalë në konkluzionin se për ndërtimin e këtij objekti në periudhën janar – qershor 2013 është shpenzuar vlera rreth 1,087,566.62 lekë. Subjekti kërkoi që të merret në cilësinë e provës ky akt ekspertim, bazuar në qëndrimin e Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 34, datë 19.2.2009⁷⁵.

57.26 Trupi gjykues administroi, në cilësinë e provës, këtë akt ekspertimi, duke e vlerësuar në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë procesit dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe babai i tij, lidhur me këtë pasuri.

57.27 Në vijim të veprimeve verifikuese, Komisioni kreu hetim pasuror për babanë e subjektit të rivlerësimit, z. Sh.L., nga ku rezultoi se ky shtetas nuk dispononte pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, përveç objektit informal me sip. 30 m² të ndodhur në ***, ndërtuar në tokën tashmë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, deklaruar për legalizim pranë zyrave të ALUIZNI-t që në vitin 2006.

57.28 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri,

Komisioni vlerëson se:

1. subjekti ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri dhe se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë dhe Drejtoria e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë;
2. shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie duken bindëse dhe të bazuara në dokumentacion provues dhe nuk ka dyshime për ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj.

58. Analiza financiare për vitet 2010 – 2016

⁷² Pajisur me nr. licence ***.

⁷³ Pajisur me nr. licence ***.

⁷⁴ Pajisur me nr. licence ***.

⁷⁵ Ndër të tjera, në këtë vendim thuhet se: «akti i ekspertimit “privat” i përpiluar nga një person i licencuar rregullisht dhe paraqitur në gjykim nga një palë ndërgjyqëse, përbën një provë shkresore që mund të lidhet me zgjidhjen e çështjes. Kjo sepse, në fund të fundit, në aspektin thjesht teknik, ai është një dokument i përgatitur nga një ekspert kompetent i fushës përkatëse të shkencës, i cili jep mendim tekniko-shkencor për konstatimin dhe sqarimin e fakteve që mund të kenë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim. Personi që ka përgatitur opinionin nuk është palë në gjykim, prandaj edhe mendimi shkencor i dhënë prej tij nuk mund të prezumohet e cilësohet vetvetiu si akt dhe qëndrim “i njëanshëm” i palës që ka porositur atë opinion. Aq më tepër kur, personi që ka përgatitur aktin, pra opinionin tekniko-shkencor, është person i licencuar rregullisht si ekspert i fushës përkatëse të shkencës, sikurse ka ndodhur në çështjen objekt i këtij gjykimi. Në një rrethanë të tillë, nuk është në kapacitetin dhe misionin e gjykatës të mos marrë parasysh kompetencën profesionale e shkencore të ekspertëve të licencuar he as të bëjë dallim mbi besueshmërinë etike e profesionale mes tyre në varësi të faktit nëse janë caktuar ose jo nga gjykata, nëse janë apo jo të angazhuar pranë institucioneve shtetërore, etj.»

58.1 Komisioni kreu analizën e treguesve financiare, pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2010 – 2016⁷⁶, nga ku vitet me balancë negative të fondeve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Analiza financiare	Viti 2011	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat e subjektit të rivlerësimit ⁷⁷	937,643	1,186,959	1,186,899	1,207,495
Të ardhura e bashkëshortes së subjektit, të vërtetuara ⁷⁸	60,166	498,975	509,064	511,608
Kredi, hua të marra ⁷⁹	925,000	500,000	0	0
Të ardhura të tjera (shitja e autoveturës) ⁸⁰	0	0	0	25,000
Total të ardhura	1,922,809	2,185,934	1,695,963	1,744,103
Pagesë shpenzime dhe transport (Përmet dhe Gjirokastër), deklaruar	240,000	240,000	240,000	240,000
Pagesë shpenzime qiraje, deklaruar	147,000	72,000	72,000	72,000
Shlyerje kredie	134,576	816,914	192,483	195,625
Shpenzime shkollimi, deklaruar, si dhe vërtetim U. Epoka	0	14,000	67,200	159,507
Shpenzime udhëtime dhe pushime	0	63,063	126,980	0
Shpenzime të tjera, sig. rivlerësime etj.	46,396	17,050	15,820	15,820
Shpenzime arredim, mobilim banese, deklaruar	950,000	0	0	0
Pagesë shpenzime jetese, familja	582,413	937,854	956,092	1,002,200
Shpenzime total	2,100,385	2,160,881	1,670,575	1,685,152
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhe, deklaruar	0	0	-200,000	-450,000
Ndryshim mj. monetare banke gj. fillim – gj. fund periudhe	26,744	-24,348	-5,185	49,424
Mjete monetare të disponueshme (1)	-150,832	705	-179,797	-341,625
Pagesa për blerje autoveturë në emër të bashkëshortes	0	290,000	0	0
Detyrime	0	0	0	0
Pagesë për blerje pasurie të paluajtshme (deklaruar pagesë kësti)	105,586.8	168,168		
Detyrime	0	0	0	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	105,587	458,168	0	0
Balanca e fondeve (1-2)	-256,419	-457,463	-179,797	-341,625

58.2 Për sa më sipër, nga shqyrtimi paraprak i vetëdeklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të administruar në dosje, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve për jetesë, arredim, transport, qira, shkollim etj., të deklaruara për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016 (referohuni tabelës së mësipërme).

59. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me balancat negative të fondeve për vitet 2011,

⁷⁶ Periudhë gjatë së cilës gjyqtari Ramiz Lala ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI.

⁷⁷ Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

⁷⁸ Sipas vërtetimeve të administruara në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

⁷⁹ Referuar dokumentacionit bankar të administruar në dosje.

⁸⁰ Fatura tatimore e shitjes me nr. serie ***, datë 27.10.2016, administruara në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

2014, 2015 dhe 2016. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe kalimit të barrës së provës, subjekti dërgoi prapësimet⁸¹ e tij në Komision, duke dhënë argumentet dhe paraqitur prova të reja për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

60. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare

60.1 Në prapësimet e sjella në Komision, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: (i) për secilin vit të analizës së mësipërme duhet t'i ulen shpenzimet e jetesës, për shkak të llogaritjes në mënyrë të gabuar nga Komisioni; (ii) në shpenzimet e jetesës në familje, të zbriten vlera e përfitimit në natyrë të produkteve ushqimore (perime + zarzavate), të pretenduara si të përfituara nga bashkëshortja e tij, nga përdorimi i tokës bujqësore në pronësinë e tij në ***, Tiranë; (iii) tek zëri i të ardhurave të bashkëshortes për vitin 2014, të shtohen si të ardhura shuma prej 45,000 lekësh, shumë e përfituar nga DAR Tiranë; (iv) tek zëri për udhëtime dhe pushime për vitet 2014 dhe 2015, të ulen shpenzimet; (v) është kryer përlllogaritje jo e saktë e lëvizjeve të llogarive bankare në emër të bashkëshortes së tij për vitin 2015, si dhe (vi) shpërndarjen e shpenzimeve të arredimit për vitet 2011 dhe 2012.

60.2 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision provat shkresore: (i) pasqyrë e të ardhurave nga kultivimi i kulturave perimore, për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016; (ii) pasqyrë e transaksioneve të llogarisë bankare të vitit 2014 në "Raiffeisen Bank", të bashkëshortes, znj. V.L.; (iii) pasqyrë e transaksioneve të llogarisë bankare të vitit 2014 në "Credins Bank", të bashkëshortes, znj. V.L.; (iv) vërtetim i pagave të bashkëshortes, znj. V.L., për vitet 2012 – 2015; (v) vërtetim i agjencisë turistike ***; (vi) vërtetim i datës 18.7.2019, i shoqërisë private "****" sh.p.k.; dhe (vii) vërtetim i datës 18.7.2019, i shoqërisë së transportit të udhëtarëve "****".

61. Qëndrimi i Komisionit lidhur me analizën financiare për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016

61.1 Komisioni, pasi i analizoi me objektivitet të gjitha pretendimet e subjektit që lidhen me analizën financiare, si dhe bazuar në dokumentacionin ligjor të administruar në dosje, vlerësoi dhe mori në konsideratë shpjegimet e subjektit që kanë të bëjë me: (1) shtesën e të ardhurave për vitin 2014, dhe konkretisht, te zëri i të ardhurave të bashkëshortes për vitin 2014 shtohen si të ardhura shuma prej 45,000 lekësh, të përfituara nga DAR Tiranë; dhe (2) uljen e shpenzimeve për vitin 2014, dhe konkretisht, te zëri i shpenzimeve për udhëtime dhe pushime për vitin 2014 do të pasqyrohet vlera 22,260 lekë⁸².

61.2 Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, Komisioni vërejt se në llogaritë e subjektit të rivlerësimit në "Raiffeisen Bank"⁸³ dhe "BKT"⁸⁴ janë kredituar për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016 vlera monetare që përfaqësojnë dieta të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, dhe konkretisht: (i) për vitin 2011, shuma prej 182,400 lekësh; (ii) për vitin 2014, shuma prej 180,457 lekësh; (iii) për vitin 2015, shuma prej 99,500 lekësh; dhe (iv) për vitin 2016, shuma prej 24,015 lekësh.

61.3 Në vlerësim të të dhënave të mësipërme, faktit se këto të ardhura nga dietat nuk janë evidentuar më parë në analizën financiare, si dhe faktit se dietat në vetvete përfaqësojnë

⁸¹ Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me *e-mail*-et e datës 12.7.2019.

⁸² Bazuar në vërtetimin datë 16.7.2019, të lëshuar nga Agjencia Turistike ***.

⁸³ Shkresa nr. *** prot., datë 1.2.2019.

⁸⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2019.

shpenzime të mundshme për udhëtim, fjetje dhe ushqim të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se në analizën financiare të zbriten shpenzimet e llogaritura më vete për subjektin e rivlerësimit për këto zëra (ushqim, transport dhe fjetje).

61.4 Pretendimet e tjera të ngritura nga subjekti i rivlerësimit nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi kryesisht kanë karakter deklarativ dhe nuk janë të bazuara në prova.

61.5 Pas reflektimit nga Komisioni të të dhënave të reja që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit, analiza financiare për vitet 2011, 2014, 2015 dhe 2016, paraqitet si më poshtë:

Analiza financiare për vitin	2011	2014	2015	2016
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat, subjektit	937,643	1,186,959	1,186,899	1,207,495
Të ardhurat e bashkëshortes, të vërtetuara	60,166	544,974	509,064	511,608
Kredi, hua të marra	925,000	500,000	0	0
Të ardhura të tjera (shitje autoveture)	0	0	0	25,000
Total të ardhura	1,922,809	2,231,933	1,695,963	1,744,103
Shlyerje kredie	134,576	816,914	192,483	195,625
Shpenzime shkollimi deklaruar si dhe vërtetim U. ***	0	14,000	67,200	159,507
Shpenzime udhëtime dhe pushime	0	22,260	126,980	0
Shpenzime të tjera	46,396	17,050	15,820	15,820
Shpenzime arredim, mobilim banesë, deklaruar	950,000	0	0	0
Pagesë shpenzime jetesë familja	582,413	937,854	956,092	1,002,200
Shpenzime total	1713385	1,808,078	1,358,575	1,373,152
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhë, deklaruar	0	0	-200,000	-450,000
Ndryshim mj. monetare banke gj. fillim – gj. fund periudhë	26,744	-24,348	-5,185	49,424
Mjete monetare të disponueshme (1)	236,168	399,507	132,203	-29,625
Pagesa për blerje autoveture në emër të bashkëshortes	0	290,000	0	0
Pagesa për blerje pasuri të paluajtshme deklaruar	105,586,8	168,168	0	0
Detyrime	0	0	0	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	105,587	458,168	0	0
Balanca e fondeve (1-2)	130,581	-58,661	132,203	-29,625

61.6 Për sa më sipër, nga shqyrtimi i vetëdeklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të administruar në dosje duket se, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve për vitet 2014 dhe 2016, vitet të cilat paraqiten me balancë negative të fondeve në total për vlerën – 88,286 lekë (referohu tabelës së mësipërme).

62. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, si rrjedhojë e kursimeve në vite nga të ardhurat e pagesë së subjektit dhe bashkëshortes së tij, në vlerën prej 750,000 lekësh.

62.1 Referuar deklaramëve periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar gjendje apo shtesa likuiditetesh *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 dhe të vitit 2016. Ndryshimi i gjendjeve të deklaruara *cash* paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendje *cash* sipas deklaramëve periodike

Viti	Gjendja në lekë, deklaruar	Shtesa/pakësime deklaruar	Gjendje pas ndryshimeve 31/12 - në lekë
2010	0		0
2011	0		0
2012	0		0
2013	0		0
2014	0		0
2015	200,000		200,000
2016	0	450,000	650,000

62.2 Bazuar në vetëdeklarimin e bërë (deklarimet periodike dhe deklarimi “Vetting”) gjendja e akumuluar e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2016 është në vlerën 650,000 lekë, ndërsa në datën 27.1.2017, është në vlerën 750,000 lekë. Për sa më sipër, rezulton se subjekti ka shtuar gjendjen e likuiditeteve *cash* me shumën prej 100,000 lekësh, për periudhën 1.1.2017 – 27.1.2017 (data e dorëzimit të deklaratës “Vetting”).

62.3 Për të evidentuar mundësinë për krijimin e kursimeve *cash* në shumën prej 100,000 lekësh, për periudhën 1.1.2017 – 27.1.2017, Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë, e cila paraqitet në tabelën si më poshtë:

Analizë financiare për periudhën 1.1.2017 – 27.1.2017

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga pagat subjekti, 1.1.2017 – 27.1.2017, “BKT”	98,685
Të ardhurat e bashkëshortes, 1.1.2017 – 27.1.2017, “Credins Bank”	42,634
Total të ardhura	141,319
Pagese për kredi këst, “BKT”	16,291
Pagesë shpenzime jetese prej 1 muaj	85,315
Total shpenzime	101,606
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim – gj. fund periudhe	- 100,000
Ndryshim mj. monetare banke gj. fillim – gj. fund periudhe	- 12,388
Mjete monetare të disponueshme	- 72,675

62.4 Për sa më sipër, dukej se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesën e kursimeve *cash* për periudhën 1.1.2017 – 27.1.2017.

63. Pas kalimit të barrës së provës subjekti dërgoi prapësimet⁸⁵ e tij të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse. Subjekti pretendoi se shpenzimet e tij gjatë muajit janar kanë qenë më të ulëta nga sa ka vlerësuar Komisioni, si dhe se gjatë festave të fundvitit 2016, fëmijët e tij kanë përfituar vlera monetare nga të afërmit dhe se këto vlera janë bërë pjesë e gjendjes *cash* të deklaruar prej tij në deklaratën “Vetting”.

⁸⁵ Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me *e-mail*-et e datës 12.7.2019.

63.1 Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet dhe paanësi, në harmoni me provat e administruara gjatë procesit, çmon se shpjegimet e subjektit mbeten të pabazuara dhe ai nuk arriti të provojë të kundërtën e këtij konstatimi. Subjekti nuk ka deklaruar vlera monetare të dhuruara për fëmijët e tij, as në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, dhe as në deklaratën “Vetting”.

63.2 Vlen të theksohet se dorëzimi i deklaratës “Vetting” është bërë më parë se dorëzimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2016, si rrjedhim, shpjegimet e subjektit se ka deklaruar gjendjen reale të likuiditeteve *cash* në deklaratën “Vetting” duken bindëse. Nisur nga fakti se sipas vetëdeklarimeve kjo gjendje *cash* është krijuar në vitet 2015, 2016 dhe muaji janar i vitit 2017, në referim të analizës financiare⁸⁶ të kryer nga Komisioni, në rastin më të keq, subjekti nuk e justifikon plotësisht krijimin e kësaj gjendjeje *cash* me shumën prej 72,675 lekësh.

64. Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

64.1 Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

64.2 Në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues çmon se këto pasaktësi dhe këto mangësi të burimeve financiare – për një total të akumuluar në shumën prej 160,961 lekësh, (me bilancin më negativ në analizën e muajit janar 2017, që arrin në minus 72,675 lekë) – nuk janë të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

64.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, nuk konstatohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

64.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit, dhe as besimin e publikut te drejtësia.

64.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

⁸⁶ Analiza financiare për vitin 2016, si dhe analiza financiare për periudhën 1.1.2017 – 27.1.2017.

65. Drejtoria e Sigurimit së Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

65.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin⁸⁷ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ku ka konstatuar se:

- i. formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës;
- iii. për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale, apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

65.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja *ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit z. Ramiz *** Lala.*

66. Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

66.1 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

66.2 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

67. Raporti i mbajtur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë

67.1 Ky raport është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

67.2 Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

⁸⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 27.10.2017.

67.3 Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

67.4 Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës së ligjit. Ai nuk ka mangësi apo kundërthënie dhe është nënshkruar në çdo fletë nga subjekti.

67.5 Të dhëna nga burimet arkivore – përvoja profesionale: Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Ramiz Lala ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 29.3.1994. Në datën 3.7.1994, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe në datën 3.8.1994 është emëruar edhe kryetar i po kësaj gjykate. Në datën 11.7.1998, lirohet nga detyra e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Në vijim, në datën 24.11.2010 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet deri më 4.11.2013, ku është emëruar gjyqtar dhe kryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ku vazhdon edhe aktualisht.

67.6 Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore rezulton se për gjyqtarin Ramiz Lala, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

68. Aftësitë profesionale

68.1 Njohuritë ligjore

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara⁸⁸, është konstatuar se subjekti e identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor administrativ dhe gjatë gjykimit i përdor ato, por në arsyetimin e vendimeve nuk gjenden raste ku ai t’i referohet parimeve në zbatimin e ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në drejtim të procedurës së gjykimit, subjekti ka njohuri të përgjithshme, por tek detajet ka vështirësi.

68.1.1 Subjektit të rivlerësimit i janë ankimuar të teta vendimet gjyqësore të vëzhguara. Në pesë raste vendimet e tij janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit (*shihni* dokumentet 1, 2 dhe 3, si dhe dosjet 1 dhe 5). Në dy raste vendimet e tij janë ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shihni* dosjet 2 dhe 4). Në një rast, vetë subjekti në cilësinë e gjyqtarit, në shkallë të parë ka vendosur mospranimin e ankimit, pasi vendimi ishte i formës së prerë për shkak të ligjit (*shihni* dosjen 3).

68.2 Arsyetimi ligjor

Nga pikëpamja formale, subjekti i harton vendimet duke ndjekur strukturën e nenit 310, të Kodit të Procedurës Civile dhe, duke iu referuar edhe nenit 41, të ligjit nr. 49/2012, me përjashtim të një rasti (*shihni* dokumentin 1). Vendimet e tij janë të ndara në pjesën hyrëse, në pjesën përshkruese - arsyetuese dhe në dispozitivin.

⁸⁸ Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në raportin e plotë të mbajtur nga Inspektorati i Lartë i KLD-së (raporti nr. *** prot., datë 14.12.2018, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala), me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa, pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

68.2.1 Ndonëse subjekti e ndan pjesën arsyetuese në rubrika të veçanta, ku një prej tyre tregon ligjin e zbatueshëm, kjo ndarje nuk është gjithnjë e qartë. Në një rast, është konstatuar se citohet përmbajtja e dispozitave ligjore, por pa treguar se kujt ligji i përketin (*shihni* dosjen 3). Në ndonjë rast, analiza ligjore e vendimit bazohet në dispozita ligjore të tjera, përtej atyre që citohen tek pjesa, ligji i zbatueshëm (*shihni* dosjet 4 dhe 5). Në një rast tjetër, tek ndarja e ligjit të zbatueshëm, paraqiten nenet 68 – 69, të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por nuk tregohet se kujt ligji i përketin këto dispozita. Në këtë pjesë, vendimi krijon paqartësi sepse të jep idenë që këto dispozita i përketin ligjit nr. 10433/2011 (*shihni* dokumentin 3).

68.2.2. Konstatohet se, subjekti përdor edhe shprehje përgjithësuese në vendim, të cilat në ndonjë rast e bëjnë të paqartë pjesën arsyetuese (*shihni* dosjen 2, ku në fjalinë e fundit, të hartuar me gjuhë përgjithësuese, subjekti shprehet se padia duhet të pranohet tërësisht, kur në fakt ka disponuar për praninë të pjesës së padisë).

68.2.3 Dispozitivi i vendimeve të hartuara nga subjekti është i qartë dhe tregohet saktësisht se çfarë ka vendosur gjykata, sipas arsytimit të bërë; pasqyrohen rregullisht shpenzimet gjyqësore; si dhe tregohet rregullisht e drejta dhe afati i ankimit.

68.3 Gjithashtu, nga analiza në tërësi e vendimeve të gjyqtarit Ramiz Lala konstatohet se arsyetimi i vendimit është në nivelin minimal.

69. Aftësitë organizative

69.1 Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka përfunduar gjithsej 4030 çështje, nga të cilat 714 çështje administrative, 312 marrëdhënie pune, 74 çështje të veçanta dhe 2930 urdhra ekzekutimi.

69.1.1 Në interpretim të gërmës “c”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ i shkallës së parë duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Nga ana tjetër, germa “k”, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, ka përcaktuar se kryetari i gjykatës, në funksionin e gjyqtarit, nënkupton realizimin prej tyre brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale, respektivisht në masën 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 180 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet⁸⁹. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e gjyqtarit Ramiz Lala konstatohet lehtësisht se ai ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë.

69.1.2 Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga subjekti ka qenë në intervale kohore 1 muaj e 14 ditë (*shihni* dosjen 1), 1 muaj (*shihni* dosjen 2), 1 muaj e 12 ditë (*shihni* dosjen 3), 20 ditë (*shihni* dosjen 4) dhe 1 muaj e 5 ditë (*shihni* dosjen 5). Në pesë dosje të vëzhguara është konstatuar se afati standard i gjykimit prej 1 muaji është tejkaluar në tre raste (*shihni* dosjet 1, 3 dhe 5), megjithatë tejkalimi është disa ditë,

⁸⁹ 60 gjykime në vit.

deri në 14 ditë. Shkaqet për tejkalimin e afatit standard të gjykimit kanë qenë procedurale, e kombinuar me ngarkesën e lartë sasiore të subjektit.

69.1.3 Gjithashtu, konstatohet se subjekti i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ngarkesës së lartë sasiore që ka pasur.

69.1.4 Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti është eficient në kryerjen e veprimtarisë gjyqësore. Ai respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar edhe ngarkesa sasiore tepër e lartë. Pavarësisht se gjykimet janë tej afatit 1 mujor, referuar kohës së tejkaluar, gjykimi respekton standardin e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në nenin 6, të KEDNJ-së. Gjithashtu, subjekti i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke arsyetuar në pjesën më të madhe të dosjeve të vëzhguara brenda afatit 7-ditor të parashikuar në pikën 3, të nenit 42, të ligjit nr. 49/2012.

69.2 Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Konstatohet se subjekti i ka vënë në lëvizje dosjet e vëzhguara përmes vendimeve formale. Subjekti zhvillon rregullisht veprimet përgatitore sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në nenin 25, të ligjit nr. 49/2012. Në vijim, cakton dhe zhvillon seancat gjyqësore, të cilat përgjithësisht janë produktive.

69.2.1 Veprimet përgatitore të subjektit kanë disa pasaktësi formale: nuk bëhet diferenca midis veprimit përgatitor dhe seancës përgatitore; aktet formulohen standard dhe nuk i përgjigjen specifikave të rastit. Në një çështje është konstatuar se eksperti është caktuar përgjatë gjykimit dhe nuk është e qartë përse ai nuk është caktuar gjatë veprimeve përgatitore (*shihni* dosjen 3). Në një rast tjetër, është konstatuar se gjatë veprimeve përgatitore nuk është identifikuar se provat e paraqitura nga gjykata, që kishin përcjellë çështjen për kompetencë lëndore, ishin fotokopje (*shihni* dosjen 5).

69.2.2 Gjatë gjykimit, subjekti kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të gjykimit ka disponuar gjithnjë me vendim përfundimtar. Kur seanca gjyqësore është shtyrë, shkaku i shtyrjes ka qenë procedural dhe seanca vijuese është caktuar shpejt dhe pa vonesa, duke mbajtur në konsideratë shkakun e shtyrjes së saj. Subjekti ka mbikëqyrur aktet e njoftimit, të cilat janë dërguar pa asnjë vonesë. Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve.

69.2.3 Në pesë çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me dy seanca gjyqësore (*shihni* dosjen 1, 2, 4 dhe 5) dhe me katër seanca (*shihni* dosjen 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 12 seanca gjyqësore, nga të cilat 10 seanca kanë qenë produktive. Janë konstatuar vetëm dy seanca gjyqësore joproduktive, ku pengesë është bërë mosparaqitja e autorizimit për përfaqësuesin prej të paditurit (*shihni* dosjen 2) dhe mosparaqitja e ekspertit (*shihni* dosjen 3).

69.3 Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht është konstatuar se gjyqtari Ramiz Lala ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Nuk ka pasur asnjë rast kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtari. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar si, kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave

përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

70. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

70.1 Etika në punë

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit nuk ka pasur të dhëna negative nga procesi i shqyrtimit të ankesave apo nga procesi i procedimeve disiplinore (*shihni* Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së).

70.2 Integriteti

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

70.3 Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

70.3.1 Nga ana tjetër, subjekti, duke qenë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka shqyrtuar vijimisht çështje administrative. Në këto raste, ka treguar kujdesin e duhur, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6, i KEDNj-së (*shihni* dosjen 2 dhe 4). Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e tij. Nuk janë konstatuar raste që gjyqtari Ramiz Lala të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

71. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

71.1 Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Ramiz Lala komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në të tria dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

71.2 Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Ramiz Lala për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Gjyqtari nuk ka pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore; nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve, përveç një rasti (*shihni* dosjen 1), që tregon se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

71.3 Gatishmëria për t'u angazhuar

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Ramiz Lala ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 29.3.1994. Ai deklaroi se ka fituar thirrjen akademike Magjistër i Shkencave Juridike - Penale /Mr.sc/2003/2004 – 2009, ka kryer studimet diplomatike në Fakultetin Juridik të Prishtinës, Kosovë dhe se ka mbrojtur me sukses të dalluar Tezën e Magjistraturës “Trafikimi i femrave si formë e krimit të organizuar në Shqipëri për periudhën 2001 – 2007”, pajisur me certifikatë, lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, në datën 31.3.2009. Kjo tezë e Magjistraturës është e botuar edhe si libër. Kjo tregon se ai i ka kushtuar rëndësi formimit akademik.

72. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

72.1 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me gjetjet e konstatuara nga raporti i KLD-së. Subjekti dërgoi prapësimet⁹⁰ e tij të shoqëruara me shpjegimet përkatëse.

72.2 Për sa i përket gjetjes për arsytim minimal të vendimeve gjyqësore, subjekti ka shpjeguar se ajo lidhet me ngarkesën tejet të madhe që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka pasur që nga krijimi i saj dhe deri më sot. Në vijim, subjekti argumenton se përveç detyrës së kryetarit të Gjykatës, ka pasur edhe ngarkesën e plotë të gjykimit të çështjeve të paraqitura në këtë gjykatë. Për periudhën trevjeçare për të cilën i është nënshtruar vlerësimit të aftësive profesionale, ka gjykuar 4030 çështje, pra, afërsisht 1343 çështje administrative në vit. Gjithashtu, ai ka sqaruar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka pasur mungesa në organikën e saj.

72.3 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka qenë në pamundësi absolute për arsyetimin e plotë të vendimeve, duke argumentuar se arsyetimi i plotë do të shoqërohej me humbje kohe shumë të madhe dhe se nga kjo kohë që do të merrte për arsyetimin vendimi i plotë, duhej që ngarkesa në punë të reduktohej, duke bërë që shumë çështje gjyqësore të mos vazhdonin të gjykoreshin sipas afateve të përcaktuara në ligjin mbi gjykatat administrative, Kodit të Procedurës Civile dhe afateve të përcaktuara nga KLD-ja.

72.4 Për të gjitha konstatimet e tjera të pasqyruara në raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga Inspektorati i KLD-së, subjekti nuk ka pasur kundërshtime.

73. Qëndrimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me raportin e KLD-së

73.1 Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

73.2 Komisioni vlerëson se gjetjet e konstatuara në raportin për Analizën e Aftësive Profesionale, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur si më sipër, qëndrojnë.

74. Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

74.1 Komisioni, administroi dhe mori në shqyrtim shtatë denoncime nga publiku. Denoncimet hidhnin dyshime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë procesit gjyqësor, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm, etj.

1. *Denoncimi nr. *** prot., datë 24.11.2017. Denoncues: B. L.*
2. *Denoncimi nr. *** prot., datë 11.12.2017. Denoncues: R. K.*
3. *Denoncimi nr. *** prot., datë 11.12.2017. Denoncues: K. B.*

⁹⁰ Prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit me e-mail-et e datës 12.7.2019.

4. Denoncimi nr. *** prot., datë 18.6.2018. Denoncues: D. Z.
5. Denoncimi nr. *** prot., datë 2.11.2018. Denoncues: Z. V.
6. Denoncimi nr. *** prot., datë 28.9.2018. Denoncues: A. D.

74.2 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se nuk ka të dhëna për të provuar pretendimet e denoncuarra për gjetje thelbësore që do të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në të shumtën e rasteve, faktet dhe shkaqet për të cilat bëhen ankesat lidhen me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit gjyqësor, të cilat vlerësohen nga gjykata në nivel më të lartë, sipas procedurës dhe këto, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni.

74.3 Bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i aftësive profesionale të gjyqtarëve çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si edhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.

74.4 Nisur nga sa më sipër, Komisioni çmon se nuk mund të komentohet një vendim gjyqësor apo zgjidhja e dhënë prej tij, për sa kohë ky vendim është në fuqi dhe nuk është prishur nga një gjykatë më e lartë dhe aq më pak të ngarkohet me përgjegjësi gjyqtari që e kanë dhënë këtë vendim. Ky argument bazohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin e saj nr. 11, datë 27.5.2004, ka sanksionuar detyrimin sipas të cilit: “Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga një gjykatë më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.

75. Denoncimi nr. *** prot., datë 18.6.2018. Denoncuesi: Anonim.

75.1 Objekti i denoncimit: figura dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij denoncimi, gjyqtari Ramiz Lala, në vitin 1998 – 1999 me urdhër të ministrit të Drejtësisë të asaj kohe, është shkarkuar si i paaftë dhe si i korruptuar. Referuar këtij denoncimi, pretendohet se z. Ramiz Lala është riemëruar gjyqtar, i ndihmuar nga segmente të politikës dhe politikanë konkretë.

75.2 Bazuar në kërkesën e dërguar nga Komisioni⁹¹, KLGJ-ja⁹² informoi se me vendimin nr. 17, datë 11.7.1998, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur largimin e gjyqtarit Ramiz Lala nga detyra e kryetarit së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe nga detyra e gjyqtarit, për shkelje të rëndë të disiplinës në punë. Bashkëlidhur ka dërguar praktikën e plotë mbi bazën e së cilës janë ndjekur procedurat për shkarkimin e këtij gjyqtari nga detyra.

75.3 Komisioni, pasi shqyrtoi këtë denoncim, dosjen e ardhur nga KLGJ-ja, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, që kanë të bëjnë me lirimin nga detyra të gjyqtarit Ramiz Lala në vitin 1998, si dhe emërimin e tij në vitin 2010, vëren:

- *Së pari*, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka ankimuar në Gjykatën e Lartë vendimin e KLD-së për largimin e tij nga detyra, e cila ka vendosur⁹³ rrëzimin e kërkesës. Por, rezulton se Gjykata Kushtetuese ka vendosur⁹⁴ shfuqizimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁹¹ Shkresa nr. *** prot., datë 12.6.2019.

⁹² Shkresa nr. *** prot., datë 21.6.2019.

⁹³ Vendimi nr. ***, datë 2.12.1998, i Gjykatës së Lartë.

⁹⁴ Vendimi nr. 48, datë 30.7.1999, i Gjykatës Kushtetuese.

- *Së dyti*, çështja për të cilën denoncohet subjekti është jashtë periudhës⁹⁵ së vlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- *Së treti*, për sa i përket vlerësimit të integritetit të subjektit, nisur nga fakti se arsyet e shkarkimit kanë të bëjnë me dyshime për abuzime të karakterit financiar të kryera në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Kukësit, Komisioni vlerëson se – përderisa në kohën kur pretendohet se janë kryer abuzimet nuk rezulton që z. Ramiz Lala të jetë kallëzuar penalisht dhe se nuk rezulton të ketë vendim penal nga gjykata që lidhet me këtë çështje, mbi bazën e të cilave do të mund të faktoheshin tej çdo dyshimi të arsyeshëm pretendimet e ngritura në atë kohë (viti 1998) – nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit të figurës së subjektit të rivlerësimit.
- *Së katërti*, për sa i përket vendimit të KLD-së për emërimin e gjyqtarit Ramiz Lala në vitin 2010, Komisioni çmon se nuk është në prerogativën e tij të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit të një organi tjetër kolegjal.

75.4 Si përfundim, Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna për të provuar pretendimet e këtij denoncuesi për gjetje që do të ndikojnë në vlerësimin e aftësive profesionale dhe në figurën e subjektit të rivlerësimit.

75.5 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, dha shpjegimet dhe parashtrori argumentet e tij për çdo denoncim të depozituar ndaj tij në Komision, sipas pasqyrit të bërë në rezultatet e hetimit administrativ.

76. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

76.1 Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramiz Lala, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar problematikat mbi gjetjet e konstatuara, ku nga vlerësimi tërësor i tyre, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk vërehen rrethana që mund të ndikojnë në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional.

76.2 Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

76.3 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

76.4 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të gurmës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

⁹⁵ Referohuni pikës 3 dhe 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ramiz Lala, me funksion gjyqtar/drejtues në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 26.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Firdes SHULI
Anëtare

Pamela QIRKO
Relatore

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore